



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODOLUKA JE PRAVNOSSNAZNA  
GYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROŠEVAC

P.nr.1014/17

Më  
Dana

24. 08. 2017

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM,  
DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri si dhe me sekretaren juridike Drita Ejupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUE], për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II. nr.1993-7/15 e datës 05.04.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini të akuzuarit [REDAKTUE] dhe mbrojtësit tij me autorizim av. [REDAKTUE], pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, me datën 17.07.2017 përpiloj me shkrim dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari:

[REDAKTUE], nga fshati [REDAKTUE], Komuna [REDAKTUE], i lindur më [REDAKTUE] nga i ati [REDAKTUE] dhe eëma [REDAKTUE] e gjinisë [REDAKTUE], i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion mekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDAKTUE]

### ËSHTË FAJTOR

Në kohë të pa caktuar gjerë më datë 15.07.2015, në rr. "Naim Beka" në Ferizaj, gjatë një kontrolli nga ana e Policisë NJHKEK së bashku me inspektorët e ATK-së, doganës dhe inspektorët Komunal, është hasur në lokalini e lojrave të fatit "NSH Market Plus" me numër të biznesit 75591472 në Ferizaj të cilin e menaxhon i pandehuri, se me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ka pa poseduar leje përkatëse të organeve komunale dhe ATK-së si dhe ka poseduar tre aparate të tipi "Kajot" dhe një të tipit "ACT" pa licencë të cilët janë konfiskuar.

- Me të cilën ka kryer veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 300 par.2, 414 të KPRK-së si dhe neneve 7,17,41,42,43,46,47,69,73, të KPRK-ës nenit 233 dhe nenit 365 të KPPK-ës, të akuzuarin e,

## GJYKON

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së do ti zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 3,600 (tre mijë e gjashtëqindë) Euro, të cilin dënim me gjobë konform nenit 46 par.2 të KPK-së, gjykata i lejon të akuzuarit që ta paguaj në tre këste por jo më të gjatë se 4 (katër) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënim i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara me nenin 46 par.3 të KPK-së do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 euro i pandehuri do të vuajë nga një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20/njëzet/- euro, në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP.II.1993-7/15 të datës 05.04.2017, ndaj të akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së.

Prokuroria e shtetit aktakuzës i ka bashkangjitur Marrëveshjen për pranimin e fajësisë të datës 05.04.2017, deklaratën e të pandehurit [REDACTED] të datës 05.04.2017 e nënshkruar nga ana e të pandehurit, mbrojtësit të tij av. [REDACTED], prokurori i shtetit [REDACTED] dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj [REDACTED]

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze me datën 03.07.2017 ka mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë së datës 05.04.2017, në të cilën i pandehuri, mbrojtësi i tijë dhe prokurori i shtetit u deklaruan përkitazi me marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke i propozuar gjykatës pranimin e kësaj marrëveshje sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas dispozitës së nenit 233 par.18 të KPPK-së, se:

- I akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,
- Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjafshesme me mbrojtësin e tijë dhe se i akuzuari nuk kanë qenë i detyruar e as i shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë,
- Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përban akuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë nga mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedures hetimore, raporti fillestari i incidentit i dates 28.10.2015, raporti i oficerit i dates 28.10.2015, si dhe shkresat tjera të lëndës, të gjitha këto prova të siguruara gjatë procedures hetimore.
- Si dhe nuk ekzistonë asnjë rrrethanë e paraparë nga neni 253 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Andaj gjykata i pranoi marëveshjet për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit për të akuzuarit.

Gjykata duke vlerësuar aspektin juridik gjeti se në veprimet e të akuzuarit [REDACTED] ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, meqë me date, kohë dhe vend siq është përcaktuar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i akuzuari në cilësinë e menaxherit të lokalit të lojrave të fatit "NSH [REDACTED]", me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm ka organizuar lojra të fatit në kundërshtim me nenin 25 të ligjit mbi lojrat e fatit 04/L-080, pa poseduari leje përkatëse të organeve komunale, ATK-së si dhe pa licencë ka poseduari tri aparate një të tipit "Kajot" dhe një të tipit "ACT".

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit gjykata vlerësoj rrrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së dhe si rrrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori se

kanë arritur marrëveshje për pranim fajësisë, sjelljen e tije korrekte gjatë procedurës penale, në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale dhe bazuar në faktin se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënameve i përcaktuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcione drejt në raport me peshën e veprave penale, rrethanave të kryerjesë së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe pësonalitetin e të pandehurit.


Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-së, që në emër të paushallit gjyqësor obligohet i pandehuri që të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ euro, në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsyet e lartëcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal**  
**P.nr.1014/17 të dt. 17.07.2017**

Sek.juridike  
Drita Ejupi

**Gjyqtari,**  
Mustaf Tahiri



**KËSHILLA JURIDIKE** – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.